

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ekonomia gjermane po rimëkëmbet, por për sa kohë?
ADRESA	https://www.cna.al/kosova-bota/ekonomia-gjermane-po-rimekembet-por-per-sa-kohe-i475152
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 06:16:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 06:09:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3470f483334bb1f402c7c838901ac40c6657013611a464aa6f290e2851198292
TEKSTI	f7957763c2cf87683c69e517bf22181e345f1b8a6e21f622942a2afb1abdb45
PAMJA	f48549afdb8f26d156a9e50b3424923160b530373591548bafddcdc3683c83bf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	12d4032eea45acf295f9910ab3c7d4015f288bdc7385ae0d49c85b2d4802651e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	b78e5a58bb99b6139c75653f203f708926b237e838138b6b7709d24a7b49499b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/12d4032eea45acf295f9910ab3c7d4015f288bdc7385ae0d49c85b2d4802651e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

08:13 Kosova & Bota

Greqia po bën përpjekje intensive për të bindur qytetarët ...

Ekonomia gjermane po rimëkëmbet, por për sa kohë?



25 Shtator 2026, 08:09, Kosova & Bota CNA



Institutet ekonomike po përmirësojnë parashikimet për Gjermaninë, por paralajmërojnë se rritja mbetet e brishtë.

"E kemi lënë pas periudhën e ngecjes dhe tkurrjes ekonomike", thotë Kancelari gjerman Friedrich Merz. Të dhënat e fundit duket se e justifikojnë këtë pohim, të paktën pjesërisht, ndërsa institutet kryesore financiare rishikojnë parashikimet e tyre të rritjes për ekonominë më të madhe të Evropës. Ekonomia gjermane po tregon shenja rimëkëmbjeje pas një periudhe të gjatë, megjithëse ekspertët paralajmërojnë se sfidat nuk kanë mbaruar.

Parashikime të reja për ekonominë gjermane

Sipas një raporti të përbashkët nga pesë institutet kryesore ekonomike të Gjermanisë, Instituti Gjerman për Kërkime Ekonomike (DIW Berlin), Instituti Ifo për Kërkime Ekonomike në Mynih, Instituti Kiel për Ekonominë Botërore (IfW), Instituti Leibniz për Kërkime Ekonomike në Halle (IWH) dhe Instituti Leibniz për Kërkime Ekonomike në Essen (RWI), ekonomia gjermane pritet të rritet me 1.3% këtë vit. Ndërkohë që para disa muajve thuhej se rritja do të jetë vetëm 0,6%. Në të njëjtën kohë, institutet parashikojnë rritje prej 1.1% për vitin 2027.

Vlerësimet nga institucionet e tjera janë gjithashtu optimiste. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) parashikon një rritje prej 1.1% si për vitin 2026 ashtu edhe për vitin 2027, ndërsa Shoqata e Industrive Gjermane (BDI) vlerëson se ekonomia do të rritet me 1% këtë vit.

Pse ekonomia gjermane po rimëkëmbet?

Rimëkëmbja është kryesisht për shkak të eksporteve më të larta, rritjes së shpenzimeve publike për infrastrukturën dhe mbrojtjen, por edhe për shkak të momentit të krijuar nga intelijenca artificiale.

"Rimëkëmbja në gjysmën e parë të vitit është kryesisht për shkak të rritjes së eksporteve", vëren Instituti Leibniz për Kërkime Ekonomike në Essen (RWI). Industritë kimike dhe farmaceutike po performojnë më mirë, ndërsa industria e inxhinierisë mekanike po përfiton gjithashtu nga rritja e kërkesës nga jashtë.

Ngritja e investimeve për infrastrukturën dhe mbrojtjen, të cilat veprojnë si një levë rritjeje për industrinë dhe investimet, po ndihmon gjithashtu në nxitjen e aktivitetit ekonomik.

Rreziqet mbeten


Pavarësisht të dhënave më të mira, ekonomistët duken të kujdesshëm. "Rimëkëmbja mbetet e brishtë, pasi kostot e larta të energjisë dhe problemet strukturore vazhdojnë të rëndojnë mbi ekonominë gjermane", paralajmëron Oliver Holtemöller i Institutit Leibniz për Kërkime Ekonomike në Halle (IWH).

Ndërsa Instituti për Ekonominë Botërore (IfW) vlerëson se ekonomia ka kaluar pikën më të ulët të krizës, por rimëkëmbja është ende e brishtë. Pasojat e luftës në Lindjen e Mesme, rritja e çmimeve të energjisë, burokracia dhe konkurrueshmëria e ulët vazhdojnë të jenë pengesa të rëndësishme.

Pritjet e ulëta afatgjata

Ekspertët paralajmërojnë se përmirësimi gjatë dy viteve të ardhshme nuk do të jetë i mjaftueshëm për të zgjidhur problemet më të thella të ekonomisë gjermane. Për vitin 2028, parashikimet variojnë midis 0.4% dhe 0.8%, duke treguar se rritja pritët të mbetet e ngadaltë pa reforma të konsiderueshme për të forcuar konkurrueshmërinë e vendit.

"Rimëkëmbja është reale, por problemet strukturore nuk janë zhdukur", thekson Torsten Schmidt i RWI, duke vënë në dukje se kostot e larta të energjisë, burokracia, mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe konkurrueshmëria e dobët vazhdojnë të ngadalësojnë ekonominë gjermane./ DW





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

Dyshohet për krime në kampin nazist të të burgosurve të luftës/ Nisin hetimet ndaj 105-vjeçës Gjermani

FOTO/ Dhjetëra delegatë braktisin sallën e OKB-së sapo Netanyahu merr fjalën

I shiti Pentagonit softuer për hakimin e telefonave/ Kompania rezulton me pronësi ruse

Rekord i ri për vitin 2026/ Ja sa emigrantë kanë kaluar brenda një dite Kanalin Anglez

Rikthimi i Turqisë në programin F-35/ Erdogan: Trump është pozitiv për këtë perspektivë

Takim Trump-Putin në dhjetor?/ Reagon Kremlini, ja çfarë mund të ndodhë

Pas bisedimeve me SHBA-në/ Lukashenko liron 15 të burgosur politikë

Çfarë strategjie mund të ndjekë Qeveria e Kosovës për apelin në Hagë?

Inteligjenca Artificiale në fokus/ Çfarë deklaruan Trump dhe Xi Jinping në Shtëpinë e Bardhë

Gjermania dyfishon parashikimin e rritjes ekonomike për vitin 2026

Raporti/ Evropa humbet 120 miliardë euro investime në vit

Trump pret në Shtëpinë e Bardhë presidentin e Kinës, Xi Jinping

SHBA paralajmëron sulme ruse me dronë në 3 shtete të Europës

BE: Keqardhje që Serbia nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për sulmin në Banjskë

Mercedes paralajmëron mbylljen e dy fabrikave në Gjermani

Zelensky në Asamblenë e OKB-së: Sa më shumë liri veprimi të ketë Putin, aq më i rrezikshëm bëhet

"Nuk takohemi me Haxhiun, pa vendosur Kuvendi për 'Specialen'"/ Letra e familjeve Thaçi, Veseli dhe Krasniqi

"Do të ketë surpriza"/ Paralajmërimi i Netanyahu para fjalimit në Asamblenë e OKB-së

Mbyllet Koloseu në Romë/ Shkak bëhet vdekja e një punëtori


Presidenti i Iranit merr fjalën në OKB/ Delegati amerikan braktis sallën

[editorial](#)

10:40 Editorial

Fshati digjet, këta krihen

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

14:39 Opinione Ylli Dylgjeri

VLORE MOJ NUR I PUSHTETIT

12:05 Opinione Luan Rama

Skandal pas skandali/ Një palo shtet anëtar i NATO-s

20:06 Opinione Grigels Muçollari

Po tani, kush do ta shpëtojë Shqipërinë nga turpërimi?!

Lifestyle

19:00 Lifestyle

Llumi i kafesë me uthull, ja truku praktik për pastrimin e kuzhinës

Një truk praktik dhe ekonomik pastrimi përfshin përdorimin...

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.